



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 59 Prot.

Tiranë, më datë 07.02.2019

**VENDIM**

**Nr. 44, datë 07.02.2019**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me V.K.M. Nr. 756, datë 26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 07.02.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Objekti “Shtesë në lartësi dhe anësore, me subjekt aplikues shoqërinë “Pegaso”sh.p.k., Tiranë”, nuk paraqet interes kulturor dhe as vlerë të trashëgimisë kulturore bazuar në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
2. Të mbajë të njëjtin qëndrim sikurse ka mbajtur edhe më parë KKR në vendimmarrjet e saj lidhur me Sheshin “Italia” të cilit duhet t’i rikthehet identiteti dhe të bëhet hapësirë publike, një vlerë e shtuar për qytetin e Tiranës;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**

